

Vendim nr. 170 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERVIN BEZHANI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-167, datë 25.01.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41 pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ervin Bezhani është djali i shtetases R. B., e cila është aksidentuar në datën 10.08.2009 si pasojë e goditjes nga rryma elektrike gjatë një avarie të rëndë të ndodhur në nën stacionin nr. 2 të repartit FEE pranë Kombinatit Metalurgjik Elbasan. Për këtë ngjarje është marrë i pandehur shtetasi V. S., përgjegjës i remontit, i akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të sigurimit teknik në punë”, të parashikuar nga neni 289, paragrafi 2, i

Kodit Penal. Në përfundim të gjykimit ky shtetas është dënuar me vendimin e formës së prerë nr. 321, datë 07.07.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me 5 vjet burgim.

2. Shtetasja R. B. i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar nga pala e paditur, CEZ-Shpërndarje sh.a., Tiranë, që t'i paguajë shpërblimin në masën e plotë të dëmit pasuror dhe jopasuror të ardhur nga kjo ngjarje. Me vendimin nr.2356, datë 12.03.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur CEZ-Shpërndarje sh.a., Tiranë të shpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror shkaktuar paditëses R. B. si rezultat i aksidentit të ndodhur në datën 10.08.2009 në masën 19.677.687 lekë”*, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3015, datë 21.12.2012.

3. Në datën 01.11.2013 kërkuesi së bashku me shtetasit S.B. dhe A.B. (përkatësisht babai dhe motra) i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me të paditur CEZ-Shpërndarje sh.a., Tiranë, me pretendimin se si pjesëtarë të afërm të familjes së të dëmtuarës u është shkaktuar një dëm jopasuror, pasi kanë pësuar dëmtime të rënda të shëndetit, të personalitetit të tyre, në marrëdhëniet dhe interesat familjare, në aspektin jopasuror.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 84, datë 28.01.2014, ka vendosur: *“Pranimin e padisë së palëve paditëse S.B., A. B. dhe Ervin Bezhani, si të bazuar në prova dhe në ligj. a) Detyrimin e palës së paditur, “Shoqëria CEZ-Shpërndarje” sh.a., Tiranë, të dëmshpërblejë, paditësin S. B., për dëmin jopasuror në formën e dëmit moral dhe ekzistencial në masën prej 4.691.358 (katër milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, sipas vlerës maksimale të dëmshpërblimit në përputhje me përlllogaritjet e aktit të ekspertimit të dëmeve shëndetësore. Detyrimin e palës së paditur “Shoqëria CEZ-Shpërndarje” sh.a. Tiranë, që t'i paguajë palës paditëse mbi bazën e përlllogaritjes së kësaj shume nga data e depozitimit të padisë në gjykatë, që është data 01.11.2013 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, pasi të këtë marrë formën e prerë, në përlllogaritje me normën bazë të interesit për depozitat. b) Detyrimin e palës së paditur, “Shoqëria CEZ-Shpërndarje” sh.a. Tiranë, të dëmshpërblejë, paditësen A. B., për dëmin jopasuror në formën e dëmit moral dhe ekzistencial në masën prej 4.691.358 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, sipas vlerës maksimale të dëmshpërblimit në përputhje me përlllogaritjet e aktit të ekspertimit të dëmeve shëndetësore. Detyrimin e palës së paditur “Shoqëria CEZ-Shpërndarje” sh.a. Tiranë, që t'i paguajë palës paditëse mbi bazën e përlllogaritjes së kësaj shume nga data e depozitimit të padisë në gjykatë, që është data 01.11.2013 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, pasi të këtë marrë formën e prerë, në përlllogaritje me normën bazë të interesit për*

depozitat. c) Detyrimin e palës së paditur, “Shoqëria CEZ -Shpërndarje” sh.a Tiranë, të dëmshpërblejë, paditësin Ervin Bezhani, për dëmin jopasuror në formën e dëmit moral dhe ekzistencial në masën prej 4.691.358 (katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, sipas vlerës maksimale të dëmshpërblimit në përputhje me përlllogaritjet e aktit të ekspertimit të dëmeve shëndetësore. Detyrimin e palës së paditur “Shoqëria CEZ-Shpërndarje” sh.a. Tiranë, që t’i paguajë palës paditëse mbi bazën e përlllogaritjes së kësaj shume nga data e depozitimit të padisë në gjykatë, që është data 01.11.2013 deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor, pasi të ketë marrë formën e prerë, në përlllogaritje me normën bazë të interesit për depozitat. d) Detyrimin e palës së paditur, “Shoqëria CEZ -Shpërndarje” sh.a. Tiranë t’i paguajë shpenzimet gjyqësore për të tre palët paditëse, si një e drejtë solidarë në shumën prej 300.000 (treqind mijë) lekë.”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur në atë gjykim, OSHEE-ja sh.a. (ish-CEZ-Shpërndarje sh.a.).

5. Me vendimin nr. 803, datë 07.05.2014, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 28.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: “Rrëzimin e padisë”, me argumentin se në kushtet kur padia i kundërdrejtohet palës së paditur “CEZ-Shpërndarje” sh.a., Tiranë si punëdhënëse, e drejta e padisë fillon që në momentin e shkaktimit të dëmit, pra ditën që ka ndodhur aksidenti në punë dhe jo nga data e vendimit penal të formës së prerë, i cili ka deklaruar fajtor shtetasin V. S. për veprën penale “Shkelja e rregullave të sigurimit teknik në punë”. Vetëm nëse shpërblimi i dëmit do të kërkohej nga ai shtetas, afati i parashkrimit do të fillojë të ecë nga dita që vendimi penal i dënimit të tij ka marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi Ervin Bezhani dhe shtetasit S.B. dhe A.B.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-167, datë 25.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

7. Në datën 25.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit gjyqësor sipas objektit, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuessit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar *parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi njëri nga paditësit në gjykim, përkatësisht S.B., babai i tij, ka ndërruar jetë përpara se të zhvillohej gjykimi në

Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, përpara se të zhvillonte gjykimin, duhej të verifikonte nëse pala paditëse në atë gjykim jetonte ende ose jo dhe më pas të bënte zëvendësimin procedural. Si rrjedhojë e këtij fakti kërkuesit i janë cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimi i barazisë përpara ligjit dhe ai i sigurisë juridike, standardi i arsytimit të vendimit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe e drejta e pronës, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimi të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin është marrë vendimi objekt kundërshtimi, si dhe është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

11. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Shterimi i mjeteve juridike efektive nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha

mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (shih vendimet nr. 18 datë 04.04.2023; nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe nuk ka më mjete për të shteruar, përveç ankimit në këtë Gjykatë.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 25.01.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 25.05.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* në kërkesën e tij sipas objektit.

14. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, një kusht tjetër paraprak për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual lidhet me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*). Sipas këtyre dispozitave, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

15. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike, standardin e arsytimit të vendimit, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Ai ka argumentuar se ato janë cenuar si rrjedhojë e faktit se Gjykata e Lartë nuk ka bërë zëvendësimin procedural të palëve në gjykim. Nisur nga fakti se përveç këtij shkak, kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument tjetër në mbështetje të pretendimeve të tij, Kolegji çmon t’i analizojë ato në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

16. Kërkuesi ka pretenduar se njëri nga paditësit në gjykim, përkatësisht babai i tij, S.B., ka ndërruar jetë përpara se të zhvillohej gjykimi në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, përpara se të zhvillonte gjykimin, duhej të verifikonte nëse pala paditëse në atë gjykim jetonte ende ose jo dhe më pas të bënte zëvendësimin procedural.

17. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.21, datë 20.03.2017; nr.28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi, për të provuar pretendimin e tij, i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues certifikatën e vdekjes të lëshuar në datën 16.05.2023 nga njësia administrative Elbasan, sipas së cilës babai i tij ka ndërruar jetë në datën 22.10.2017, pra përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, Kolegji vëren se rekursi është paraqitur dhe nënshkruar edhe prej kërkuesit, që do të thotë se rrethana e vdekjes së palës ndërgjyqëse, babait të tij, dhe formimi i ndërgjyqësisë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë nuk provohet të ketë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë tek interesat e kërkuesit, në kuptimin e cenimit të të drejtave kushtetuese të tij. Për më tepër, në fazën seleksionuese, kolegji i Gjykatës së Lartë verifikon vetëm elementet formale të rekursit dhe, si rregull, nuk ka detyrimin për kalimin procedural të palëve, në ndryshim nga rasti kur çështja kalon fazën e seleksionimit dhe gjykohet në themel në seancë publike ose në dhomën e këshillimit. Po kështu, edhe vetë kërkuesi në ankimin e tij kushtetues individual nuk ka paraqitur ndonjë argument lidhur me faktin nëse ka vënë në dijeni Gjykatën e Lartë për këtë rrethanë. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.